

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR Ping Wini 88

Neni 1:

DATA E THEMELIT, EMRI DHE THEMELUESIT

Sot, më date 06.01.2025 (Gjashtejanardymijeenezetepese), une Damiano Feti Qemali, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar kam krijuar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin **Ping Wini 88**, Elbasan. Per kete qellim une ortaku I vetem i shoqerise **Ping Wini 88**, Damiano Feti Qemali, hartoj kete Akt Themelimi.

Neni 2:

ORTAKET THEMELUES

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin **Ping Wini 88** Elbasan, themelohet nga ortakët e me poshtem:

1. Damiano Feti Qemali, i lindur me date 17.06.1994, me Leter Njoftimi Nr. 039598629 dhe me ID:J40617066W, banues ne Elbasan,Rr. Refik Serica, Nderresa 4 Hyrja 1, Elbasan 3001;

Neni 3:

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin **Ping Wini 88** do te jete person juridik shqiptar, te cilin do ta fitoje kur te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te shoqerive tregtare.

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet sipas dispozitave te ketij Akt Themelimi, statutit te shoqerise **Ping Wini 88** dhe Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjeve te tjera specifike qe rregullojne veprimtarite tregtare ne RSH.

Neni 4:

SELIA, ADRESA, ADRESA ELEKTRONIKE,
KOHEZGJATJA

Selia e shoqerise **Ping Wini 88** eshte ne adresen : Lagjia "Brigada 17 Sulmuese", Pallati 92, Zona Kadastrale Nr.8522, Numri I pasurise 2/85+2-1, (REGJ 8522-418), Elbasan.

Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon :
e-mail : damianoqemali@gmail.com

Veprimtaria e shoqerise do te vazhdoje per nje periudhe kohe **te pacaktuar**.

Neni 5:

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: **Sherbime pastrimi**.

Neni 6:

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (Njeqindmije) Leke. Pjesëmarrja e ortakeve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Damiano Qemali, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 (Njeqindmije) Leke, ose 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kontributi i ortakut te vetem do te derdhet ne Raiffeisen bank, Elbasan.

Ortakët, me miratimin e asamblese se pergjitheshme, nuk kufizohen ne rritjen e kontributeve te tyre.

Damiano Qemali:


Neni 7:

FONDET E SHOQËRISE

Shoqëria do të krijojë fonde pekatese, mbështetur në Statut dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të cilat regjistrohen në Librin e caktuar për këto qëllime.

Neni 8:

NDARJA E FITIMIT TE SHOQËRISE

Fitimi neto që do të realizohet nga shoqëria, i cili do të mbetet pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve dhe krijimit të rezervave të detyruara do t'i kalojë ortakëve në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

Neni 9:

PERGJEGJESITË E ORTAKËVE

Ortakët janë përgjegjës kundër të tretëve për pasojat dhe dëmet që rrjedhin nga anulimi ose deklarimi të pavlefshëm të Aktit të Themelimit të shoqërisë.

Po ashtu ortakët janë përgjegjës në masën e kontributeve në kapitalin e shoqërisë edhe për të gjitha humbjet që mund të rezultojnë gjatë aktivitetit ekonomik të shoqërisë.

Neni 10:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Problemet e kapitalit themeltar dhe të kuotave, transferimi i kapitalit zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit, menyra e administrimit të shoqërisë, emerimi i administratorëve dhe ekspertëve kontabel të regjistruar, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, menyra e mbajtjes së llogarive kontabel, falimentimi, shndërrimi i shoqërisë, zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe problemet e tjera që lidhen me veprimtarinë e shoqërie do të zgjidhen sipas dispozitave të Statutit të shoqërisë, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Elbasan me datë 06.01.2025

ORTAKU THEMELUES

Damiano Qemali
D. Q.